

Gjetjet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Prishtinës që nga viti 2005-2011

Qendra Kosovare për Gazetari Huluntuese, botuese e Preportr dhe Organizata ÇOHU! Në kuadër të hulumtimit mbi funksionimin e Komunës së Prishtinës që nga viti 2000 e deri më tani, ka këqyrë gjetjet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) për këtë institucion që nga viti 2005, kur edhe kanë filluar të publikohen raportet e para e deri në raportin për vitin 2011, që është raporti i fundit i publikuar nga ZAP për Prishtinën.

Nga këto raporte del se megjithëse krerët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) që po udhëhiqnin me Komunën e Prishtinës nderonin ndër vite, por ZAP po gjente shkelje të njëjta të ligjit në këtë institucion.

Në vitin 2005 auditorët gjetën se Komuna e Prishtinës nuk kishte një sistem të besueshëm të kontrollit të brendshëm. Menaxhimi financiar ishte çuditërisht i bazuar në besim e jo në kontroll dhe në këto rrethana humbjet apo mungesat – dobësitë e fondeve nuk mund të vërehen. “Mjedisi i kontrollit në këtë formë do të mund të konsiderohet si mjedis me rrezik të lartë”, konstatonin auditorët në vitin 2006, për vitin fiskal 2005.

“Kontrolli i tërësishëm i dokumentacionit tregon se keq-pohimet në raportin financiar janë të pranishme dhe ndikojnë në kualifikimin e rezultatit të auditimit”, ishte një konstatim tjetër për atë vit i ZAP-it.

Auditorët kishin gjetur se mungon regjistrimi i pasurisë i Komunës së Prishtinës, gjetje që do të vazhdonte deri në vitin 2011, se në këtë komunë vazhdonin të operonin ende tri njësi të prokurimit, çka, njëjërën nga to, atë për prokurime në shëndetësi u gjetën një sërë shkeljesh të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

Në vitin 2006 auditorët nuk gjetën përmirësime por vërejtën edhe shkelje të tjera. Ata gjetën se Komuna e Prishtinës, atë botë nën udhëheqjen e Ismet Beqirit, kishte 2 llogari të hapura bankare të pa- autorizuara në “KSB Bank”, dega në Prishtinë,, fondet publike shpenzoheshin pa kaluar në shënimet financiare të komunës dhe pa respektuar procedurat e parapara me rregulla, bëhej përvetësim i paligjshëm i pasurisë publike. Auditorët gjetën edhe mos-kryerje të kompetencave nga ana e menaxhmentit andaj i rekomanduan:

“Ndalja e ndërtimeve pa leje, vjeljen e tatimit në pronë, pajisja me leje për punë e bizneseve dhe mbikëqyrje të tyre” i shkruanin si rekomandim auditorët Ismet Beqirit. Auditorët, në letrën që i kishin shkruar atëherë Beqirit, konstatuan se komuna që ai drejton as në vitin 2006 nuk ka arritur që të ketë informata te përgjithshme për pasurinë fikse.

Sipas raportit vjetor 2006 në komunë janë kryer 326 ndërtime për objekte te banimit, objekte afariste, mbindërtime, shndërrime , objekte kolektive etj. Prej tyre vetëm 66 me leje ndërsa 260 pa leje. “Komuna ka dështuar në ndalimin e ndërtimeve pa leje”, konstaton ZAP.

Për parkingjet publike nëpër trotuare, Komuna e Prishtinës kishte kontraktuar kompaninë “Beni Dona Plast”, pronë e Ragip Mustafës, që më vonë do të bëhej pothuajse biznesmeni kryesor që shpërblehej me tenderët publik në këtë institucion dhe kompaninë “LTG”. ZAP gjeti se të dy kompanitë i mbetën borxh komunës, dhe vlera e borxhit mbërrinte në 164,480

Auditorët gjetën mos-përputhje pagesash edhe te kontrata për bartjen e automjeteve, fitues i kontratës të së cilës ishte biznesi “Besa Cola”. Në Agjencionin e Bizneseve del që “Besa-Cola” me nr. biznesi 80015224 është prone e Ali Sekiraçës.

Po në vitin 2006, ZAP gjeti parregullsi në kontratën me kompaninë AMM, prone e Gezim Salihut dhe Ahmed Kurtollit. Kjo kompani më vonë do të ishte financuese e LDK-së, partia që tradicionalisht udhëheq me qeverinë lokale në Prishtinë. Preportr ka publikuar deri më tash dy hulumtime (“Monopoli komunal në reklama” dhe “AMM – Absolut Mustafa Monopol”,) për këtë kontratë, por ka hasur në bllokim total nga ana e Komunës së Prishtinës, kur bëhet fjalë për qasje në dokumente publike-kontratën e “AMM”-së me Komunën e Prishtinës.

Auditorët që në vitin 2006 gjetën se çmimet e kësaj kontrate, të lidhur mes komunës në fjalë dhe “AMM-së” janë për 50% ma të ulëta se tarifat komunale ekzistuese. Ndër shkeljet e tjera që ishin gjetur në këtë kontratë, ishte se në panotë e ekspozuara vërejtëm se reklamohet duhani dhe alkooli edhe përkundër asaj se në rregulloren komunale për taksa e tarifa është e ndaluar të reklamohen këta artikuj, se ishin lëshuar dy akt-vendime të kundërligjshme mbi këtë kontratë, njëra për vendosjen e posterit të Bill Klintonit ndërsa tjetra për lirim për promovimin e albumit muzikor. “Për asnjërën nuk janë përdorë procedura të prokurimit. Mosrespektim i kushteve të kontratës për artikujt që dëmtojnë shëndetin. Mungesë e transparencës dhe devijim nga rregullat për taksa dhe tarifa”, ishin disa nga gjetjet e ZAP për kontratën, deri tash sekrete, në mes të Komunës së Prishtinës dhe financuesve të LDK-së, Kurtolli e Salihu.

Në vitin 2006, ZAP gjeti edhe se një sërë shkollash fillore e të mesme kishin lëshuar objekte me qira dhe kanë inkuar të ardhura edhe nga lëshimi i dokumenteve, por që lëshimi me qira ka qenë i kundërligjshëm, pa u zbatuar Ligji i Prokurimit Publik.

Në po këtë vit ishte gjetur edhe se Teatri Kombëtare i Kosovës (TKK) kishte organizuar një festival, me emrin “Kosova Infest”. Atë kohë teatrin e drejtonte tash i ndjeri Teki Dervishi, një kohë të gjatë edhe drejtor në “Bota Sot”, gazetë e cila për një kohë të gjatë është identifikuar me LDK-në. Ndonëse aktiviteti në fjalë ishte i institucioneve të nivelit qendror, Komuna e Prishtinës vendosi ta financonte me 25 mijë euro. Çuditërisht, mjetet ishin derdhur në xhirlogarinë personale të Dervishit dhe atë pa ndonjë kërkesë ,vendim apo projekt.

Në vitin 2007, auditorët gjetën se ende pasqyrat financiare të vitit 2007 janë të pasakta. Në këtë vit, ata po vazhdonin “tregimin” për “Beni Dona Plast” të Ragip Mustafës. “Nga viti 2005 Komuna ka pasur

kontratë me ndërmarrjen “Beni Dona” për dhënien ne shfrytëzim te vendeve për parkim publik në rrugët e qytetit Lot. III dhe IV. Kjo kontratë është vazhduar edhe një herë deri me 30.06.2006. Nga zyrtarët përgjegjës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike është thënë se është vazhduar edhe për vitin 2007. Mirëpo, kjo nuk është ofruar si dëshmi ekipit të auditimit. Sipas kontratës vlera e shumës si kompensim është 7,020 euro për muaj, dhe me kushtet e pagesës brenda 15 ditëve në fillim të muajit vijues. Gjatë vitit 2007 kjo shumë e pagesës është rishikuar dhe është zvogëluar me arsyetime të ndryshme, pa mbështetje ligjore sipas opinionit tonë. Sipas një raporti përkatës thuhet që obligimet e mbetura për vitin 2007 janë në vlerë 88,817 euro. Po ashtu komuna nuk ka bërë shpalosje në PF të vitit 2007 për të arkëtueshmet e pa inkasuar në vlerë 88,817 euro”, konstaton ZAP në vitin 2007.

Në këtë vit, ZAP i hyri këqyrjes së tenderëve, ku në gjashtë kontrata me vlerë 3,316,850 euro gjeti se garancioni për sigurimin e ekzekutimit është bërë pas pranimit teknik te punimeve në kundërshtim me LPP-në që obligon autoritetin kontraktues që të kërkojë nga kompania që i është dhënë një kontratë , të depozitojë një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrim dhe hyrje në fuqi të kontratës.

Këtë vit auditorët gjetën se parregullsitë në paga, shpenzim të parasë së imtë e mos-deklarim të borxheve ndaj furnitorëve, po vazhdonin.

Në vitin 2008, auditorët gjetën fillimisht se nga 10 rekomandimet e dhëna një vit më parë, pesë ishin implementuar pjesërisht ndërsa të tjerat mbeten ende të pa implementuara.

Edhe pse kjo komunë, vazhdimisht ankohej për buxhet të vogël, auditorët gjetën se buxheti prej 47.3 milionë eurosh ishte shpenzuar vetëm 73 %, derisa të pa shpenzuara mbetën mbi 12.7 milionë euro.

Kjo praktikë do të vazhdonte për krejt vitet me radhë, ku suficiti i këtij institucioni do të kalonte shifrën 15 % të vlerës së përgjithshme të buxhetit, që praktikisht, kurrë Komuna e Prishtinës nuk arriti që të implementojë as 90% të buxhetit.

Auditorët, edhe tri vite më vonë, edhe pse përmendën këtë problem që në vitin 2005, vazhduan të konstatojnë se Komuna e Prishtinës nuk e di sa e ka pronën. “Komuna e Prishtinës nuk mbanë një Regjistër gjithëpërfshirës dhe të qartë të pasurisë fikse, ku do të paraqitet vlera e përgjithshme e pasurisë së saj”, konstaton ZAP në vitin 2008.

I filluar që në vitin 2006, problem “Beni Dona Plast”, po vazhdonte edhe në vitin 2008. Kjo kompani, pronë e Ragip Mustafës, dhe kontraktor i rregullt i Komunës së Prishtinës duke filluar nga furnizimi me xhama, hamburgerët për nxënës...darkat për zyrtarë, e deri te rregullimi i rreth-rrotullimit, vazhdonte të menaxhonte me parkingjet publike në Prishtinë, pa kontratë që nga viti 2007, dhe pa i kryer obligimet që nga vit 2006.

“Kontrata e lidhur me datën 02.06.2008 në mes Komunës dhe operatorit “Park Projekt itg” nga Prishtina, në emër të koncesionit të parkingjeve të qytetit në dy zona të qytetit (zona I dhe II gjithsej 357 vend parkime), parasheh që operatori të paguaj në llogari të Komunës çdo muaj nga €7,800. Nuk kemi gjetur asnjë pagesë në vitin 2008 të kësaj kompanie në dobi të llogarisë komunale. Borxhi i tërësishëm

prej vitit 2006 deri në fund të muajit shkurt të vitit 2008 kap shumën prej €95,148, plus pagesat tjera që i takojnë vitit 2008 (7muaj x 7,800= €54,600);

“Gjithashtu kompania “Beni Dona Plast” nga 01.07.2007 deri më 29.02.2008 ka menaxhuar me parkingjet publike pa vazhdim të kontratës dhe borxhi i saj ndaj komunës vlerësohet në €50,137”, konstaton ZAP kur bëhet fjalë për borxhet.

ZAP kishte gërmuar thellë në të kaluarën e Komunës ë Prishtinës dhe i doli se kjo komunë ka punësuar 36 punëtorë në emër të një pilot-projektit për financa dhe tatim në pronë që nga viti 2001, por të cilët edhe në vitin 2008 vazhduan të punojnë mbi bazën e këtij pilot-projekti të 7 viteve më parë.

ZAP duke hetuar në tenderët e kësaj komune gjeti se në vitin 2008 tek dy raste sigurimi i ekzekutimit të punëve është bërë pas nënshkrimit të kontratës dhe pas përfundimit të punës atëherë kur edhe janë kryer të gjitha pagesat ndaj kompanive, për punën e kryer, praktikë që ishte ndjekur edhe një vit më parë dhe po ashtu ishte konstatuar si e kundër-ligjshme një vit më parë nga ZAP.

Komuna e Prishtinës po vazhdonte me aktivitet të kundërligjshme në prokurim. Kështu, ZAP gjeti se bash në tenderin për ndërtimin e objekti të ri të Komunës së Prishtinës, ky institucion kontraktoi një kompani të papërgjegjshme. “OE (Ndërtimtari) fitues nuk ka qenë i përgjegjshëm, ngase nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara. Operatorit fitues i ka munguar raporti i auditimit dhe ka ofruar vetëm pasqyrat financiare të nënshkruara nga një auditor.. Ky kriter ka qenë një ndër arsytet e eliminimit të operatorit ekonomik më të lirë prej €351,201. Punimet fillestare në objekt gjatë 13 ditëve të para janë zhvilluar pa praninë e organit mbikëqyrës”, konstaton ZAP.

Preportr nuk ka marr përgjigje nga Komuna nëse është marrë ndonjë masë në këtë rast.

Shkelje ishin gjetur edhe në tenderin për ndërtimin e rrugës Slivovë - Viti e Marevcit, ku për situacionin e dytë është paguar shuma prej 505,000 eurosh nga MTPT-ja në bazë të faturimit, ndonëse punimet për këtë vlerë të paguar nuk ishin kryer, derisa dosja standarde e tenderit për kompaninë fituese “Alko Impex”, pronë e Imer e Fatime Ademi nga Prishtina nuk është gjetur komplet. Kjo kompani ka marr më vonë një sërë tenderësh në Komunën e Prishtinës, derisa është edhe kontraktor i rregullt i Ministrisë së Infrastrukturës.

Ishte viti 2008, dhe ZAP ende po jepte alarmin, sikurse në vitin 2005, dhe të cilin do ta vazhdojë deri në vitin 2011 që kontrollet e brendshme të vendosura nga menaxhmenti i komunës për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve, parregullsive dhe mashtrimeve potenciale nuk po funksionin mjaftueshëm

ZAP-it në vitin 2006 i ishin paraqitur dy llogari bankare në “KSB”, dega në Prishtinë, si llogari të pa- autorizuar, për të cilat në vitin 2008 bënë një përpilim të veçantë për gjendjen e tyre. “Sipas informative që disponojmë, këto dy llogari bankare janë hapur në vitin 2000 me autorizim të administratorit të atëhershëm të UNMIK-ut për komunën e Prishtinës”, konstatuan ata.

Por, auditorët gjetën se më 2005-ën ka pasur tërheqje nga këto llogari që nuk dihet se kah kanë shkuar paratë. “Për tërheqjet e parasë që janë bërë në vitin 2005 nuk mund të konkludojmë se si janë

shpenzuar këto mjete. Këto mjetet janë tërhequr në të gatshme”, konstatojnë auditorët e Komuna e Prishtinës s’ka koment.

Në vitin 2009, auditorët gjetën se në vitin 2008 kishin dhënë 24 rekomandime për Komunën e Prishtinës, por ky institucion, tash i drejtuar nga pasardhësi i Ismet Beqirit, profesori i ekonomisë, Isa Mustafa se veç pesë rekomandime ishin implementuar pjesërisht ndërsa të tjerat as që u adresuan.

Këtë vit auditorët konstatuan edhe u blenë 27 herë më shtrenjtë se çmimi real te tenderi “Furnizim me katër automjete për brigadën e zjarrfikësve”. Kjo paraqiste mashtrim, dhe “Prishtina Insight” kishte gjetur se krejt tenderi ishte i kurdisur. Megjithëkëtë, pronarët e këtyre kompanive, të familjes Zymeri, që kurdisën këtë tender, u shpërblyen më vonë me tenderin për rregullimin e shesheve “Ibrahim Rugova” e “Zahir Paraziti”.

ZAP gjeti se një gabim në specifikacionin teknik nga komuna ka rezultuar që të ndryshojë edhe vlerat e të gjithë ofertuesve. Ky gabim kap vlerën mbi 17,000 € për fituesin. “Kushtet e veçanta të kontratës nuk janë në përputhshmëri me kontratën e lidhur sepse pagesat në kontratë janë paraparë të bëhen 1/3 nga vlera e kontratës për punët e kryera e jo ½ siç parashihej në kushtet e veçanta. Po ashtu, sigurimi i ekzekutimit i ofruar nga operatori ekonomik nuk i përgjigjet kushteve të kontratës. Sigurimi i ekzekutimit është kërkuar për 12 muaj, ndërsa ishte ofruar vetëm për 2 muaj”, konstaton ZAP për një tender që i ishte dhënë kompanisë ABC nga Podujeva, pronë e Arben Jetullahut, e cila është njëra ndër kompanitë që merr vazhdimisht tenderë publik në Komunën e Prishtinës.

Ndërtimi i rrethrotullimit në lagjen “Arbëria” që i është besuar ‘Noti’, për te cilin auditorët gjeten se “Raporti për pranim të punëve nuk i përket projektit ndërtimi i rrethrotullimit, por të një projekti tjetër”. Noti ishte futur, bashkë me 8 kompani të tjera, në një listë të Drejtorisë së Infrastrukturës në Komunë e Prishtinës, të cilësuar si “lista e zezë”, por e cila nuk kishte pasur ndikim konkret, pasi që Zyra e prokurimit po vazhdonte t’i shpërblente këto kompani.

“9 kompanitë për të cilat Drejtoria e Infrastrukturës Lokale konstatoi se nuk i kanë përmbushur kontratat janë: “Linda” nga Ferizaj, “Toifor” nga Prishtina, “Noti” nga Prishtina, “ABC” nga Podujeva, “Park projekt” e NTP “Dellova” nga Prishtina, “Gashi-ing” nga Suhareka, “Ekskavatori” nga Ferizaj, “Euro-Garden” nga Lipjani dhe “Unikom” nga Suhareka. Pos që nuk u ndëshkua asnjëra nga to, disa prej tyre sivjet edhe janë shpërblyer me tenderë, siç janë: “Toifor” nga Prishtina, “ABC” nga Podujeva, “Park projekt”, “Euro-Garden” nga Lipjani etj. Arsyeimi i komunës është se atyre u intereson veç çmimi”, raportonin mediet në vitin 2010.

I përcjell që nga viti 2005, problemi i pasurisë së komunës nuk u zgjidh as më 2009-ën, edhe pse tash ne krye ishte Isa Mustafa: “Komuna gjatë vitit 2009 nuk kishte arritur të hartojë një regjistër gjithëpërfshirës dhe të qartë për pasurinë fikse. Përveç inventarizimit në fund të vitit, nuk kishte formuar një komision për vlerësimin e pasurive fikse, siç janë: toka, ndërtesat dhe rrugët”.

Në vitin 2010, auditorët e gjetën Komunën e Prishtinës përsëri keq me mos-zbatim të rekomandimeve. “Në raportin tonë të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të vitit 2009 janë dhënë 10 rekomandime kryesore. Prej këtyre rekomandimeve, dy janë adresuar plotësisht, dy pjesërisht, ndërsa gjashtë të tjera janë në proces të implementimit. Këto gjashtë rekomandime ndërlidhen me”, thuhet në këtë raport.

Auditorët gjetën se kjo komunë, megjithëse publikisht kërkonte buxhet më të madh duke kritikuar Qeverinë Qendrore të udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e kryeministrit Hashim Thaçi, për mos-ndarje të buxhetit më të madh, kishte arritur që të shpenzonte vetëm 75 % të këtij buxheti që ishte 64.4 milionë euro.

Si në Qeverinë Qendrore të PDK-së, edhe në Prishtinën e udhëhequr tradicionalisht nga LDK-ja në fund të vitit “i jepej zor” për të shpenzuar buxhetin, ku në vitin 2010 në këtë periudhë, tre-mujëshin e fundit ishte shpenzuar gati 50 % e buxhetit në pagesa.

Kjo komunë edhe pse tash e dy vite drejtohej nga një ekonomist, që mban edhe ligjërata në Universitetin Publik për këtë punë, sipas ZAP-it, pasqyrat financiare nuk po i përgatiste sipas legjislacionit në fuqi, me çka është shkaktuar shpalosje jo e drejtë dhe jo e saktë e të dhënave financiare.

Auditorët këtë vit gjetën se në Komunën e Prishtinës ka pasur mos barazim të të hyrave për lejet ndërtimore, në një vlerë prej mbi 10 mijë eurosh, rënie e inkasimit për tatimin në pronë në masën 6 %, dhe ku nga mos marrja e masave sipas legjislacionit në fuqi, komunës i ishte grumbulluar një borxh mbi 4.2 milionë eurosh.

Auditorët gjetën edhe se te shkolla e mesme “28 Nëntori” kishte pasur të hyra nga arsimi jo formal dhe trajnimi për instruktor 67,020€, të cilat nuk u regjistruan drejt, e sipas kodeve përkatëse.

Në këtë komunë, një vit më vonë do të arrestohej nga Policia e Krimeve Ekonomike ish-shëfi i prokurimit, Ekrem Rexha, nën dyshimin se kishte paguar situacione të kompanive ende pa i kryer punët, por kjo, sipas gjetjeve të ZAP, duket të jetë praktikë e rregullt.

Në vitin 2010 auditorët gjetën se Kompanisë “Liridoni” nga Ferizaj, pronë e Ekrem Esatit, deri sa kishte kryer veç 53% të punëve në shkollën e Hajmalisë, iu kishin paguar mbi 70 e pagesave të një kontrate që peshonte mbi 800 mijë euro.

Ndryshe, për këtë projekt, tenderi ishte anuluar një herë, derisa në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) Komuna e Prishtinës ishte përballur me kompaninë “Albes” nga Istogu, pronë e familjes së gazetarit dhe botuesit të “Epokës së Re”, Muhamet Mavraj. “Albes” kishte arritur që të dëshmonte në OSHP se vetëm për dy vite kishte pasur qarkullim mbi 20 milionë euro. Kjo kompani, sipas raportimeve të më hershme të Preportr, është fitues tradicional e tenderëve të MASHT-it, dikaster i udhëhequr atëherë nga Enver Hoxhaj, tash krye-diplomat i Kosovës.

Para se hetuesia të merrej me Ekrem Rexhen, ishte ZAP që gjeti shkeljen të Kolektori Atmosferik, që i ishte dhënë kompanisë “Çlirimi” nga Prizreni, pronë e Sali Dakaj. “Ne projektin “Ndërtimi i kolektorit

atmosferik”, në shumë prej 3,045,674€ është paguar operatori në vlerë prej 846,712€ për furnizime me material ndërtimi, e jo për punët që ndërlidhen me projektin në fjalë. Me datën 14.12.2010 kësaj kontrate i është shtuar një amendament për ndryshimin e kushteve të pagesës në të cilin është paraparë që operatorit t’i paguhet shuma në emër të furnizimeve me material ndërtimor e jo për punët e kontraktuara”, u konstatua më 2010-ën, auditorët.

Kur këtë punë e mori në duar Prokuroria Speciale, i pari i Prishtinës, Isa Mustafa, e pati akuzuar Policinë dhe Prokurorinë së po punonin për Shërbimin Informativ të Kosovës (SHIK). Një nga komentet e medieve të afërta me PDK-në atë kohë ishte: “Isës po i dëftohet SHIK-u”.

Hyrja në kontrata pa zotime të mjaftueshme, vonesat në realizimin e projekteve, pagesat e projekteve përmes kodeve të ndryshme ishin edhe disa nga çështjet të cilat po i shqetësonin auditorët në Komunën e Prishtinës.

Në vitet paraprake edhe në vitin 2010, komuna e Prishtinës kishte humbur aq konteste gjyqësore, sa që kishte paguar mbi gjysmë milioni euro, të regjistruara si shpenzime për gjyq.

Ishte viti i 5-të që ZAP po publikonte raporte për Prishtinën dhe ende si e gjetur ishte: mos-regjistrimi i pronës komunale. “Mos formimi i një komisioni për regjistrimin e pasurive kapitale rrit rrezikun që pasuritë apo prona publike të keqpërdoret”, konstatonte ZAP më 2010-në, përafërsisht siç kishte konstatuar më 2005-ën.

Auditorët kishin përshkruar edhe një sërë gjetjesh në këtë vit, të cilat i quan në konstatimin se “niveli i kontrollit financiar është joadekuat” në Komunën e Prishtinës.

Në vitin 2011, auditorët gjetën se në 2010 janë dhënë 11 rekomandime kryesore. Prej këtyre rekomandimeve, 2 (dy) janë adresuar plotësisht, ndërsa 9 (nëntë) janë adresuar deri në një masë të caktuar.

ZAP gjeti se komuna e Prishtinës as në vitin 2011 nuk e shpenzoi buxhetin sipas planifikimit, dhe mbeti me një tepricë prej 23 %.

Edhe këtë vit komuna e ekonomistit Isa Mustafa po vazhdonte me tabela të shënimeve të buxhetit të cilat ZAP, i konsideron jo të plota dhe të pasakta.

ZAP përmend konkretisht paraqitjen e asnjë vlere tek detyrimet kontingjente në këto shënime, derisa komuna kishte një kontest gjyqësor me fabrikën e amortizatorëve në Prishtinë, në vlerë prej 383,025€.

Auditorët gjetën edhe se nga mos-puna e zyrtarëve të Komunës dhe mos-ushtrimi i kompetencave karshi ndërtuesve, komuna ishte dëmtuar për afro 5 milionë euro. “Gjatë rishikimit të listave të borxheve të papaguara nga taksat për leje të ndërtimit, kemi identifikuar se komuna nuk i kishte ekzekutuar garancionet... Borxhet e pa arkëtuara nga viti 2008 deri me 2011 ishin në vlerë prej 4,988,920€”, konstaton ZAP.

Edhe në vitin 2011 Komuna e Prishtinës kishte vazhduar me pagesa për kompanitë për punë të pakryer, pagesa të bëra sipas furnizimit të materialeve, e jo sipas punëve të kryera, siç ishte vepruar me kontratën “Sanimi i rrafshit rrëshqitës në lagjen Arbëria” në vlerë prej 696,258€ që i ishte besuar kompanisë A&A, menaxhimi jo i kënaqshëm i derivateve të naftës për ngrohje për institucionet shkollore etj.

Në vitin 2011 Komuna e Prishtinës më në fund, sipas ZAP-it bëri një regjistrim prone, por që nuk ishte përsëri i plotë. “Komuna e Prishtinës posedon një regjistër të pasurisë, mirëpo ky regjistër nuk është i plotë dhe i saktë. Komuna ende nuk ka arritur t’i përfshijë ndërtesat që shfrytëzohen nga bashkësitë lokale, objektet shëndetësore, arsimore dhe pasurinë tjetër në këtë regjistër, për shkak se nuk ishte në gjendje t’i vlerësojë ato. Po ashtu, vlera e tokës prej 540,000€ e prezantuar në PVF nuk është e saktë”, konstaton ZAP.

Mangësi në kontrollin financiar ishte gjetur edhe këtë vit, kurse ZAP-i shprehu shqetësim të madh për auditimin e brendshëm. “Auditimi i brendshëm në komunë është jo efikas dhe nuk i shërben qëllimit në kohën e duhur”, konstaton ZAP.